



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
SENATI AKADEMIK

Nr. 1168/1 Prot.

Vlorë, më 12 . 07. 2021

VENDIM

Nr. 32, datë 05. 07. 2021

PËR
MIRATIMIN E FORMATIT TË DIPLOMËS SË PROGRAMIT TË INTEGRUAR TË
CIKLIT TË DYTË "MASTER I SHKENCAVE NË DREJTËSI"

Në mbështetje të nenit 38, të Ligjit Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", në nenin 19 të Statutit të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë, Udhëzimit nr. 10, datë 30. 03. 2020 "Për përcaktimin e elementeve përbërës, formën e diplomës ose certifikatës së lëshuar nga ILA-të dhe procedurës së regjistrimit të tyre në regjistrin e tyre në diplomave ose certifikatave për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor", si dhe referuar shkresës nr. 1042 prot, datë 18. 06. 2021 të Zv/ Rektorit Akademik, Senati Akademik në mbledhjen e datës 05. 07. 2021

VENDOSI:

1. Të miratojë propozimin e zv/ Rektorit Akademik të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë sipas shkresës nr. 1042 prot, datë 18. 06. 2021 për elementët dhe formën e diplomës së lëshuar nga Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë për Programin e Integruar në Drejtësi me elementët si më poshtë:

"Program i Integruar i Ciklit të dytë "Master i Shkencave në drejtësi"

Elementët tekst të formatit:

1. Emërtimi "REPUBLIKA E SHQIPËRISË", UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË, FAKULTETI (Time New Roman 12).
2. Emërtimi "Diplomë e Integruar" (Augusta Regular 36).
3. Teksti ".....e studimeve të ciklit të dytë "Master i Shkencave" në "Drejtësi".
4. Numri i lërditeve 300 ECTS (Times New Roman 12).
5. Niveli përkatës i diplomës 7 KSHK. (Times New Roman 12).
6. Emri, Atësia, Mbiemri, në kllapa mbiemri që mban në momentin e diplomimit nëse është i ndryshëm (Microsoft Seans Serif 12 i vijëzuar poshtë).
7. Vendi dhe data e lindjes (Microsoft Seans Serif 11).



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK

8. Shënimi "Në përfundim të studimeve të integruara të ciklit të dytë, pas plotësimit të detyrimeve akademike të programit përkatës dhe mbrojtjes së tezës diplomohet" (Berlin Sans FB).
9. Emri i Dekanit dhe Rektorit (Microsoft Seans Serif 10) lihet bosh për t'u plotësuar me shkrim dore.
10. Në të majtë mbi emërtimin "Dekani" janë vendosur (Berlin Sans FB 10).
 - Numri unik i identifikimit të diplomës sipas QSHA/MASR në momentin e regjistrimit të formës së diplomës.
 - Nr. i Matrikullimit të studentit.
 - Data e regjistrimit në institucion për programin përkatës.
 - Nr. i Matrikullimit të Ciklit paraardhës të studimeve.
 - Nr. i diplomës së studimeve të mëparshme.

Në të djathtë, mbi emërtimin "Rektori" janë vendosur:

- Nr. i Diplomës.
 - Vendi dhe data e lëshimit.
 - Data e përfundimit të studimeve.
 - Forma e studimit.
11. Në fund të diplomës shtohet shënimi "Kjo diplomë shoqerohet nga suplementi i saj (Berlin Sans FB 10).
 2. Diploma përmban të gjitha elementet teknike dhe elementet e sigurisë të përcaktuar në Vendimin e Senatit Akademik nr. 105, datë 20. 11. 2020.
 3. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Fakulteti i Shkencave Humane dhe Drejtësisë si dhe Zv/Rektori Akademik dhe Drejtoria e Ciklit të parë dhe të dytë të studimeve.
 4. Bashkëlidhur dhe pjesë e këtij vendimi gjendet formati i diplomës për këtë program studimi.
 5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

NËNKRYETARI I SENATIT AKADEMIK

Prof. As. Xhiliola AGARAJ (shetru)

